

# Balkan PERSPECTIVES

*Revistë për ballafaqimin me të kaluarën*

**Ballkan100 –  
Ballafaqimi me të kaluarën**

**Kujtimet e viktimave të luftës  
dhe tiranisë një reflektim i  
përgjithshëm në kontekstin  
gjerman**

**“Laboratori i kujtesës”:  
Ta shikosh Ballkanin Perëndimor  
si pjesë integrale të Evropës**

## SI KUJTOJMË?



03. EDITORIAL

04. MJEGULLA E SË KALUARËS NUK PO LARGOHET NGA MAQEDONIA

05. CILI ËSHTË KUJTIMI YT I PREFERUAR?

08. "NJË SËMUNDJE E ÇMUAR DHE E TRASHËGUAR E MELANKOLISË DHE KRENARISË"

11. KUJTIMET E VIKTIMAVE TË LUFTËS DHE TIRANISË NJË REFLEKTIM I PËRGJITHSHËM NË KONTEKSTIN GJERMAN

14. "LABORATORI I KUJTESËS": TA SHIKOSH BALLKANIN PERËNDIMOR SI PJSË INTEGRALË TË EVROPËS

PËR ATA QE SJANË .16

KOSOVA DHE MAQEDONIA: .18  
NË KËRKIM TË IDENTITETIT

ZËRAT E PËRBASHKËTA .19

GISHTI .20

GAZETARËT MAQEDONAS: .21  
BALLAFAQIMI ME TË KALUARËN  
ËSHTË I DOMOSDOSHËM PËR MEDIET

GAVRILLO PRINCIPE – HERO .22  
KOMBËTAR APO TERRORIST

LAJME DHE PËRDITËSIME .23

IMPRESUM .24



BALKAN100-  
BALLAFAQIMI ME TË  
KALUARËN

12



MURET E HESHTJES  
DHE TË MOHIMIT

10



KUJTIMI ËSHTË  
GARANTUES  
I PAQES

06

# EDIT- ORIAL

- Prishtinë/Kosovë,
- dhjetor 2014

Të dashur lexues,

**L**uftërat gjithmonë përbëjnë një katastrofë të theksuar për një shoqëri meqë shkatërrojnë rendin social dhe ballafaqojnë individin me dhunë e vdekje. Ato gjithashtu ndryshojnë identitetin e të gjithë pjesëmarrësve të përfshirë në konflikt. Shoqëritë e pasluftës në Ballkanin Perëndimor kanë krijuar narracione të ndryshme mbi të kaluarën, të cilat shpërputhen në shumicën e rasteve dhe zakonisht janë të ndikuara nga një pikëpamje etnocentrike.

Kjo revistë e re, “*Balkan.Perspectives*”, është një përgjigje për këto narracione që janë në kundërshtim me njëri-tjetrin, dhe ka për qëllim të prezantojë një kujtesë alternative dhe mënyra alternative të ballafaqimit me të kaluarën në Serbi, Maqedoni, Kosovë dhe Bosnjë e Hercegovinë. Revista u ofron një platformë aktorëve vendës e rajonal që janë të përkushtuar në hulumtimin e mënyrave gjithëpërfshirëse të ballafaqimit me të kaluarën. “Ballafaqimi me të kaluarën” nuk është ndonjë koncept artificial, por përfshin aktorë të ndryshëm si artistët, hulumtuesit, aktivistët e shoqërisë civile, përfaqësuesit shtetëror dhe shumë të tjerë. Ne duam t’u ofrojmë lexuesve tanë një varg perspektivash për ta bërë temën e “ballafaqimit me të kaluarën” më të prekshme për shoqëritë në Ballkanin Perëndimor. Nëse dëshironi ta keni revistën rregullisht, ju lutem gjeni informatat për ta porosit atë në linkun: [balkan.perspectives@forumzfd.de](mailto:balkan.perspectives@forumzfd.de). Revista do të publikohet tri herë në vit në katër gjuhë të ndryshme (në gjuhën maqedonase, shqipe, serbo-kroate e boshnjake dhe në gjuhën angleze).

Tema e parë e “*Balkan.Perspectives*”, shqyrton çështjen e kulturave të ndryshme të përkujtimit. Siç tregon “muri i kujtimeve” në fotografën në ballinë, e kaluara përbëhet gjithmonë nga kujtime të vogla e të panumërta të individëve. Në një nivel shoqëror, përkujtimi i së kaluarës do të duhej të reflektohte këto kujtime të ndryshme dhe t’i kontribuonte krijimit të një narracioni historik që do të respektohej nga të gjitha palët.

Autorët tanë u përpoqën ta trajtojnë këtë çështje duke iu qasur nga këndvështrime të ndryshme. Në artikullin tonë kryesor, Dino Mustafiq, një regjisor i njohur teatri nga Bosnja, shtron pyetjen se përse përkujtimi është crucial për shoqëritë e sotme dhe se si përkujtimi ndikon në të ardhmen tonë të përbashkët. Dr. Thomas Lutz analizon se si e kaluara mund të kujtohet, ndërsa prezanton një rishikim të strategjive të përkujtimit në Gjermaninë e pasluftës. Nikola Radiq, një artist serb, na tregon se përse ka zgjedhur të punojë në temat që ndërlidhen me historinë dhe se si ai e definon përkujtimin e së kaluarës për veten e vetë.

Artikuj të tjerë prezantojnë iniciativa nga rajoni, të cilat i janë qasur përkujtimit të së kaluarës në mënyra të ndryshme: përmes një foto-projekti që përfaqëson familjarët e të pagjeturve në Kosovë, përmes hulumtimit kualitativ në Maqedoni dhe përmes projekteve që njerëz të rinj kanë mbledhur për të reflektuar kulturën e përkujtimit në Ballkanin Perëndimor.

Ne mirëpresim dhe çmojmë mendimet dhe reagimet e juaja për revistën tonë. Ne shpresojmë se do t’u pëlqejë revista “*Balkan.Perspectives*” dhe se ajo do tu inspirojë që të reflektoni mbi kulturën e juaj personale të përkujtimit.

- Singërisht,
- Maike Dafeld, Kryeredaktore

# MJEGULLA E SË KALUARËS NUK PO LARGOHET NGA MAQEDONIA

**T**rembëdhjetë vite pas konfliktit në Maqedoni, I cili ka tendosur marrëdhëniet ndërmjet dy grupeve më të mëdha etnike, duket se shteti nuk është duke bërë mjaft për t'i pajtuar palët dhe për të siguruar stabilitet shoqëror. Për institucionet shtetërore dhe faktorët e tjerë, ballafaqimi me të kaluarën nuk është një mjet për ndërtimin e paqes dhe harmonisë ndërmjet qytetarëve, derisa po vazhdojnë tensionet etnike, ekskluzivisht ndërmjet gjeneratave të reja.

Kroati Goran Bozinoviq, ekspert në fushën e “Ballafaqimit me të Kaluarën”, thotë se procesi është në një fazë të hershme në Maqedoni. “Diversitetin etnik në Maqedoni e cilësoj si pasuri dhe avantazh. Brenda dialogjeve ndër-etnike, ekziston nevoja për të punuar në ballafaqimin me të kaluarën, por ky është vetëm një segment. Ne kemi nevojë të flasim për temat për të cilat nuk flasim, të dëgjojmë ata me të cilët nuk pajtohemi në mënyrë që të ecim drejt së ardhmes. Qëllimi nuk duhet të pengohet, ndërsa nuk duhet të lejohet që fëmijet tanë ta bartin mbi vete barrën tonë”, thotë Bozinoviq.

Sipas Albert Hanit nga OJQ-ja “forumZFD”, Maqedonia është duke shkuar zvarrë në këto procese.

“Maqedonia si shtet, thënë kushtimisht, është duke u vonuar në trajtimin e kësaj teme, por çdo fillim është një mundësi e re, sepse shumë gjëra të ndërlydhura me këtë çështje janë neglizhuar. Këto çështje duhet të adresohen në të ardhmen, sepse na japin mundësi të mira për të mos përsëritur gabimet që janë bërë në të kaluarën”, tha Hani.

Rafiz Haliti, ish-ushtar i UÇK-së që aktualisht është deputet dhe zëvendëskryetar i parlamentit, pohon se shteti duhet të bëjë këto përpjekje.

“Mendoj se nuk është vonë kurrë. Gjeneratori që çon në konflikte do të duhej të ishte identifikuar deri më tani. Nëse njerëzit e bëjnë këtë me sinqeritet, do të jetë shumë me e lehtë të gjinden pikat e përbashkëta në të ardhmen. Kjo është në interesin e shtetit dhe të gjithë kombit”, konsideron Haliti për të shtuar se procesi duhet të nis nga institucionet më me ndikim siç është Akademia Artit dhe Shkencës e Maqedonisë.

Ish-gjenerali i policisë maqedonase, Stojanco Angelov, i cili kishte marrë pjesë në konflikt në anën e opozitës, thotë se këto procese varen në masë të madhe nga situata ekonomike në vend.

“Sigurisht se ka mënyra, por do të jetë e vështirë. Asnjë zgjidhje nuk do të jetë e mundshme nëse Maqedonia vazhdon të zhytet në varfëri. Fillimisht, është esenciale të përmirësohet situata ekonomike në shtet e në të njëjtën kohë duhet të punohet në përmirësimin e marrëdhënieve ndër-etnike në një mënyrë më të organizuar, më intensive dhe më gjithëpërfshirëse”, rekomandon ai.

Duke marrë parasysh rrethanat politike në Maqedoni, ekspertët rekomandojnë se politikanët, mediat dhe akterët e tjerë në vend, u nevojitet një shtytje e madhe për të nisur seriozisht të merren me ballafaqimin me të kaluarën.

Mefail Ismaili dhe Maja Vaseva

## SERBIA

**Borko Kasanski, 42**

**Kujtimi im më i preferuar ka të bëjë me një moment specifik: momenti kur e kam parë gruan time në një ndarëse të tejdukshme të hapësirës në seksionin e lekturimit të “Veçernje novosti” dhe kur e kemi shikuar njëri-tjetrin në sy. Ky kujtim ka mbetur i gjallë që nga ajo ditë në vitin 1998. Sidoqoftë, nëse përqendrohemi në këtë takim të parë, më kujtohet çdo detaj-tërheqja, ngurrmi dhe dëshira për të qenë bashkë. Më vonë, kemi pasur shumë momente të bukura së bashku (fëmijët, puna,...), por kujtimi mbi takimin e dy shpirtrave binjakë mbetet në brendësinë time favoriti i padiskutueshëm.**

**Marija Majstoroviq, 32**

**Një gjë e sigurt në jetën time është se kurrë nuk do ta harroj momentin kur jam bërë nënë para diku nëntë vitesh. Kam lindur një vajzë shumë të lezetshme, e cila u bë me motër pas pesë vitesh dhe me një vëlla pas një viti tjetër shtesë. Është diçka e pakrahasueshme kur e shikon foshnjën për herë të parë dhe kupton se çdo gjë është në rregull.**

• • • • •



# Cili është kujtimi yt i preferuar?

.....

**Martini, 19**

Isha në një koncert dhe pjesa hyrëse e tij më fascinoi- ky është kujtimi im i preferuar.

**Natasha, 47**

Kujtimi im i preferuar është lindja e fëmijët tim. Sot, ai është 19 vjeç dhe është duke studiuar.

**Biljana, 33**

Më pëlqen të kujtoj pushimet që kisha me dy miq në Ohër. Qëndruam atje për një javë dhe qeshëm aq shumë. Ishte e mrekullueshme.

**Anastasia, 28**

Kujtimi im i preferuar ka të bëjë me kohën kur po qëndroja në Londër për tre muaj. Tezja dhe kushëri im jetojnë atje. Më pëlqen vendi shumë dhe ishte e mrekullueshme ta shoh familjen time sërish.

## MAQEDONIA

## KOSOVA

**Arbër, 45**

Kujtimi im i preferuar është kur ka lindur vajza ime.

**Vjolla, 21**

Unë kam qëndruar në Shqipëri gjatë luftës. Kur jemi kthyer në shtëpi, gjithçka ishte e shkatërruar dhe shtëpia jonë nuk ishte më, por ne po ktheheshim në shtëpi dhe ky është kujtimi im i preferuar.

**Ron, 35**

Kujtimi im i preferuar është përfundimi i luftës. Ne kuptuam se nuk do të vdisnim dhe se ishim të lirë për të jetuar.

**Mërgim, 31**

Më pëlqen të kujtoj shikimin në qiell kur isha katër apo pesë vjeçar.

**Valdrin, 12**

Unë pata shkuar me familjen time në Shtetet e Bashkuara. Atje ka shumë lojëra dhe kjo më pëlqen-ky është kujtimi im i preferuar.

## BOSNIA DHE

**Branka, 36**

“Kujtimet e mia më të fuqishme e më të bukura janë ato të fëmijërisë. Të dielave në mëngjes, e gjithë familja bëhej bashkë dhe shikonte në qetësi programin `Nedeljini zabavnik` (program argëtues javor)”.

**Ado, 33**

“Më kujtohet se si prindërit e mi më mbronin fuqishëm dhe në mënyrë të sigurtë gjatë luftës. Lidhja ime e parë me luftën nuk ka të bëjë me vdekjen apo urinë, por me kujdesin e prindërve të mi. Ne gjithmonë kemi pasur pak bukë, e cila gjatë vitit 1993 ishte në një mënyrë e vetmja gjë që kishim për të ngrënë. Por, prindërit e mi na kanë mbrojtur mua dhe motrën time nga lufta aq shumë sa kanë mundur”.

**Mirsada, 63**

“Çka më kujtohet? Më së shumti më kujtohet jeta para luftës, sepse atëherë ndihesha i gjallë. Ajo periudhë e jetës ishte më e bukura. Që nga nisja e luftës e deri më sot, kemi çdo gjë përveç jetës”.

## HERCEGOVINA

.....

# KUJTIMI ËSHTË GARANTUES I PAQ

BiH

Dino MUSTAFIQ



.....



**K**ujtimi është një pjesë e rëndësishme e jona, pjesë e qenies sonë. Përvojat tona në Ballkan janë të veçanta. Ne kemi nevojë dhe për obligim t'i bartim kujtimet tona përtej ndjeshmërisë së të tjerëve, sepse kjo i jep një perspektivë të ardhmes, në të cilën urrejtja dhe luftërat nuk do të përsëriten si refrene përgjatë historisë. Domethënia dhe përzgjedhja e asaj që duhet të kujtojmë është një nga çështjet thelbësore të shoqërisë sonë.

Fatkeqësisht, kujtesa jonë është selektive dhe ka kaluar në filtrin e marrëdhënieve sociale a politike brenda të cilave ngjarjet historike vëzhgohen pa kontekst apo lidhje reciproke me kohën e shfaqjes së tyre. Shpesh mund të jemi dëshmitarë të mënyrës se si neglizhohen faktet dhe se si ushqehet kultura e harresës dhe e gënjeshtrove. Arti është i rëndësishëm në mbajtjen e kujtimeve, sepse përbën një tregim për individin, sepse është i ndjeshëm ndaj manipulimit dhe uzurpimit, sepse bën fjalë për njerëzit që janë ende gjallë, përderisa historia është "e lavdishme" dhe merret me të kaluarën. Gjuha artistike krijon hapësirë për të ardhmen duke besuar që mendja dhe imagjinata në komunikim me audiencën mund të krijojë një botë paralele të paqes dhe lirisë.

Për këtë arsye, e kaluara shpesh shërben si inspirim për krijime artistike, sepse kujtesa individuale ofron mundësinë e vet-reflektimit (vet-vlerësimit). Në të kundërtën, kujtesa historike shpesh herë përdor interpretimet për të relativizuar faktet, u qaset gjërave nga këndvështrimi i fituesit dhe falsifikon të kaluarën. Arti guximtar, i sinqertë dhe kritik është një nga mënyrat për të ri-vlerësuar rolin dhe përgjegjësinë e individëve, bashkësive dhe të shtetit në dhunë dhe terror.

Literatura, filmat, teatri, shfaqjet muzikore dhe pikturat e krijuara viteve të fundit ishin një kujtesë kreative përmes së cilës krijohej një fushë e lirisë që dallon nga e kaluara e cila ishte paraqitur si ankth, e keq dhe

gjak. Punime të tilla kanë prekur historinë dhe kujtesën në një mënyrë të përgjegjshme dhe humane përmes prizmit të mikro-botës së individëve dhe viktimave; ato kanë tejkaluar të gjitha barrierat ekzistuese nacionale e muret e urrejtjes; ato kanë rizgjuar dhembshurinë dhe na kanë bërë ta rivlerësojmë vetëdijen dhe keqardhjen tonë.

Arti është gjithashtu një luftë kundër apatisë së vjen nga e keqja, që poshtëron viktimat e që thëllon çarjet në mes të komuniteteve etnike. Të kujtosh një ngjarje e ringjall atë. Të kujtosh një karakter e ndërlihd atë me ngjarjen. Ne nuk mund të harrojmë se çfarë ka ndodhur, por duhet të falim. Për të ndodhur kjo duhet të shkruhet çdo fjalë, duhet të matet pasha e çdo pike loti dhe e secilës sakrificë. E vetmja mënyrë për ta bërë këtë është që të ushqehet kultura e simpatisë dhe e ndjeshmërisë në mënyrë që gjeneratat e ardhshme të mos i përsërisin mizoritë ndaj atyre që u takojnë etnive apo feve të ndryshme.

*Nëse qëndrojmë indiferent ndaj mësimëve të së kaluarës, do të bëhemi indiferent ndaj shpresave të pandashme për të kaluarën.*

Nëse qëndrojmë indiferent ndaj mësimëve të së kaluarës, do të bëhemi indiferent ndaj shpresave të pandashme për të kaluarën. Kështu arrijmë deri në esencë: Nëse harrojmë, do të na harrojnë". Për këtë arsye, kujtesa është garantues i paqes. Artistët e ndjejnë botën përmes rrahjeve të zemrës së tyre dhe e shohin jetën si parim të vlerës më të lartë. Për shkak të kësaj, ekziston një lidhje solide ndërmjet artistëve dhe kujtesës, sepse pa trajtim të ndërgjegjshëm e të vetëdijshëm të së kaluarës, e ardhmja është e pamundshme.

*Dino Mustafiq është një regjisor i njohur i teatrit dhe filmit në Bosnjë e Hercegovinë. Ai ka kryer studimet në Akademinë e Arteve Aplikative në Sarajevë. Ai është kreu i festivalit më të vjetër teatral në rajon-Festivalit të Teatrit Ndërkombëtar. Pas rrethimit të Sarajevës, ai ri-themloi këtë festival me bashkëpunëtorët e tij. Trashëgimia kulturore e luftërave të fundit në Bosnjë është e pranishme në punën e tij kreative.*



# “NJË SË- MUNDJE E ÇMUAR DHE E TRASHËGUAR E MELANKO- LISË DHE KRENARISË”

“Fever / vlera numizmatike”, 2013, Media e përzier,  
Vepër artistike: Nikola Radiq Lucati, Hulumtimi: Dr  
Milovan Pisarri. Shqafur në "Vot Ken Ju Mach" ekspozita në  
KhD - Kunsthaus Dresden



*Nikola Radiq Lucati është rritur në Beograd në një familje artistësh. “Në pothuaj secilën dorë në familjen time mbahej një laps, një brushë apo një kamerë. Faktikisht jam rritur duke vizatuar dhe bërë fotografi”, shpjegon ai. Gjatë studimeve në Beograd dhe Jerusalem, ai kuptoi se kujtesa kolektive keqpërdorej për të ndarë dhe radikalizuar qytetarët e Jugosllavisë së viteve të '80-ta dhe '90-ta. “Kjo formë e manipulimit përdor kulturën si medium dhe mund të luftohet suksesshëm në këtë fushë”, thotë ai. Në intervistën në vijim, ai flet për kulturën e kujtimit, ballafaqimin me të kaluarën në Serbi dhe rolin e artit.*

## **Nikollë, kultura e kujtimit është një fjalë që përdoret shpesh. Çka nënkupton ajo për ty?**

Për mua, kultura e kujtimit ka vetëm një marrëdhënie kaluese drejt kulturës. Është një ambient i projeksioneve ekonomike e politike që ndryshon në mënyrë dinamike. Paketimi kulturor është një mjet i përshtatshëm që kufizon pasojat e ri-definimit konstant të produkteve politike e ekonomike si pjesë e kulturës.

Problemi paraqitet kur tregime të ndjeshme historike bëhen subjekt i një trajtimi të tillë të vrazhdë. Ajo për të cilën mbi të gjitha po flasim, është humbja e historisë reale ndaj një mekanizmi në ri-redaktim dhe censurimit konstant. Një nga metodat për ta luftuar këtë është rikthimi në dokumentet origjinale, të paredaktuara, të dëshmuara, artefakteve dhe përfshirja e tyre në ri-ekzaminimin e kushteve të tashme të tregimit.

## **Jetoni dhe punoni në Beograd. Çfarë kuptimi ka kultura e kujtimit në Beograd?**

Në Serbi, kultura e kujtimit tradicionalisht është çmuar dhe trashëguar si sëmundje e melankolisë

dhe krenarisë, e ushqyer nga mjerimi i vazhdueshëm dhe viktimizimi tepër real i popullit serb dhe minoriteteve të tij. Kujtesa kolektive, e cila për shekuj dinte si të glorifikonte heronjtë dhe ta ruaj besimin, ishte shndërruar në një varg tregimesh të ndërlidhura dhe pastaj- historia zyrtare- për ripërdorim të vazhdueshëm nga ideologët e saj nacionalistë që nga vitet e 1930-ta.

Sot, “kultura e kujtimit”, ose, “kujtimi për të harruar”, fatkeqësisht nënkupton shkëlqej revizioniste të historisë përmes tentimeve të vazhdueshme për të arritur deri te një tregim i vetëm dhe afirmativ kombëtar. Kërkimi për “Kryqin e Shenjtë” në hegemoninë e pakontestueshme të mitologjisë kombëtare mbi historinë po konvertohet aktualisht në qëllime modeste dhe të arritshme siç janë avantazhi politik, përfitimet ekonomike, shmangia e dëmshpërblimit dhe të tjera.

## **Ju jeni një artist që merret me të kaluarën. Pse duhet arti të merret me kulturën e kujtimit?**

Siç ka treguar vala e fundit e censurës dhe dëbimeve nga puna në media dhe institucione të kulturës, shteti nuk mund

të lihet i vetëm në të njëjtën dhomë me historinë dhe kulturën e tij pa ndonjë të rritur apo një lloj mbikëqyrjeje. Projekti kombëtar ekspansionist i Serbisë është rreshtuar kah parimi “nëse jo më i madh, atëherë më i dëlirë”. Partitë neo-naziste janë në rritje dhe shumica e sulmeve janë bazuar në ndarjet klasore dhe kërcënimet raciste. Minoritetet nuk përbëjnë më 40% të popullatës dhe mediet po shndërrohen në tabloide, në mbrojtje panike të Darwinizmit ekonomik me nacionalizmin e ringjallur, e megjithatë, jo-sovran. Derisa hapësira kulturore vihet në pikëpyetje nga historia faktike, asnjë gjeneratë e re nuk mund udhëheq krijimin e një qasjeje të re, kategorike dhe etike ndaj rolit që arti e kujtimi luajnë si platform pluraliste për një shoqëri demokratike.

## **Të flasim për punën tuaj. Si merreni me kulturën e kujtimit?**

Në punën time, unë përdor dokumentarët dhe kërkimet empirike mbi subjektet që janë pjesë e procesit periodik. Shpesh kthehem tek vendet, ri-lexoj dhe ri-marr në pyetje tregimet që duket se janë “të përcaktuara” për shkak të modeleve shpesh herë të neglizhuara. Kjo ka



tendenca të bëhet personale dhe e lejoj vetën të zhytem në temë me mundësinë që ta mbi-indentifikoj vetën me të. Në përpjekje për të shmangur rreziqet e mbi-redaktimit dhe thjeshtëzimit, unë ofroj pjesë të mëdha të gjetjeve të pandryshuara, siç janë gjetur në arkiva ose siç janë dokumentuar në vendngjarje.

Kujtesat historike, kolektive dhe personale nuk janë të këmbyeshme dhe duke i bërë zërat e tyre të ndryshme që të dëgjohen, unë përpiqem të tregoj proceset themelore të adaptimit konstant të gjuhës së kujtimit të komuniteteve të viktimave të minoriteteve, meqë ato vazhdojnë të mbijetojnë duke përvetësuar projeksionet e shumicës dominuese.

**Jeni marrë me kulturën e kujtimit për një kohë bukur të gjatë. A keni vërejtur ndonjë ndryshim në vetë kulturën ose në mënyrën se si shoqëria, politika dh arti merren me të?**

“Të merresh me atë” është një përshkrim i mirë. Kjo “atë”, është duke “u trajtuar” në nivelin e mesëm të menaxhimit të rregullimit të problemeve të tanishme në marrëdhëniet publike. Meqë kjo “atë” po shihet edhe si mundësi e mirë komerciale, “atë” është duke u bërë pjesë në rritje, e zhvilluar në mënyrë dinamike, gjysme e privatizuar e marrëdhënieve lokale e nacionaliste, kulturës dhe ekonomisë. Një eko-sistem i tillë nuk është në gjendje të ofrojë rezultate relevante për edukimin etik të bazuar në përvojën e Holokaustit dhe të gjenocideve, por është përgjegjës në krijimin e konflikteve të reja. Megjithatë, publiku ende po reagon ndaj kësaj mungese etike. Edhe pse gjeneratat e viteve pas të 90-ave të shoqërisë serbe janë rritur me interpretime selective të historisë, numri i pjesëmarrësve në diskutime dhe ekspozita është duke u rritur, ndërsa audiencat duket se janë të interesuara të angazhohen për të shfaqur ndjenjat dhe për të treguar mbështetje.

Boshllëku etik dhe emocional ndërmjet qasjes shtetërore dhe përgjigjes së njerëzve rrallë herë ka qenë më e gjerë, ndërsa ndërtimi gradual i edukimit alternative mbi historinë civile mund të çojë në krijimin e një baze të përbashkët të narracionit për të rritur një kulturë të re, joeksklusive të kujtimit.

**Për çfarë lloji të shoqërisë mendoni kur merreni me të kaluarën në mënyrë artistike? Cila është utopia e juaj?**

Një nga gjërat e vogla që po zbehen nga presioni i depolitizimit të kulturës është utopia për lirinë dhe barazinë përmes krijimit të memories “së kulturuar” të tyre si një e kaluar më e mirë. Sikurse e kaluara, utopitë janë të rrezikshme. Por, për dallim nga të kaluarat, janë vlen gjithmonë të luftosh për to.

<http://www.nikolaradiclucati.com/>



Shënimi –“ ara me shpellën që ishte aty dhe tërë drurët që ishin në arë dhe në të gjithë kufijtë përçark (Zanafilla 23:16), Shfaqur në “Missing Places” në KC Grad, 9-15.8.2012. Kuruar nga Dejan Atanacković.

# MURET E HESHTJES DHE TË MOHIMIT



XHABIR DERALLA

**K**ujtesa e së kaluarës-ndërtimi i së ardhmes është një projekt që u përpoq të trajtojë disa tema të ndjeshme brenda fushës së ballafaqimit me të kaluarën në Republikën e Maqedonisë. Projekti vjen në kohë të vështira për vendin i cili po ballafaqohet me një përkeqësim serioz në përmbushjen e standardeve në fushën e të drejtave bazike të njeriut, demokraci dhe sundim të ligjit. Vendi, i cili për një kohë të gjatë ka një mosmarrëveshje të hapur mbi emrin me Greqinë dhe që po has në telashe gjatë krijimit të identitetit të vet kombëtar, po qeveriset aktualisht nga një koalicion në mes të partive të shumicës maqedonase dhe atyre të minoritetit të gjerë shqiptar.

Qeveria, si e tillë, është e shqyer nga brenda. Pjesa etnikisht maqedonase e qeverisë përipiqet ta imponojë identitetin e shumicës maqedonase, kryesisht të krishterë ortodoksë, si identitet kombëtar duke shpërfillur minoritetet e shumta etnike dhe kombëtare, kryesisht të fesë islame. Ndërtimi i një shteti dhe identiteti multi-etnik e multi-kulturor është një parakusht tjetër në procesin e integritimit Euro-Atlantik të vendit, një premisë që kërkohet nga pjesët e përparuar të shoqërisë dhe nga minoritetet.

Shoqëritë në Ballkan, në përgjithësi, vuajnë për disa shekuj nga dallimet dhe përplasjet mbi identitetin dhe nga mbivendosja e historive. Në këtë kontekst, Maqedonia është ndoshta në pozitën më të ndjeshme me territor, emër, identitet, gjuhë dhe histori të kontestuar nga vendet fqinjë. Edhe brenda vet shoqërisë ka një debat të vazhdueshëm mbi çështje esenciale brenda këtyre temave. Në rrethana të tilla, Civil dhe *forumZFD* kanë kryer një pilot-hulumtim shumëdimensional në tri komuna etnikisht të përziera në vend, përfshirë një komponentë të projektit në nivel nacional, duke përdorur një kombimin të hulumtimit veprues dhe duke reflektuar mbi metodologjitë e praktikave mbi paqen.

Hulumtimi përfshiu ngjarje historike dhe procese që nga Kryengritja e Ilindenit për çlirim nga Perandoria Osmane më 1903 e deri më sot.

Hulumtuesit e Civil u përpoqën të zbulojnë format dhe përmbajtjen e kulturave lokale të kujtimit sikurse perceptimet e përfaqësuesve relevant të komuniteteve etnike, vendimmarrësve dhe akterëve mbi funksionet e kulturës lokale të kujtesës. Hulumtuesit gjithashtu bënë përpjekje të kuptojnë se cili është perceptimi i pjesëmarrësve të shumtë në hulumtim mbi kulturat lokale alternative të kujtesës së orientuar kah e ardhmja. Fatkeqësisht, fare pak dritë mund të shihej në fund të tunelit. Deri më tani. Të ngjuara me politikat partiake, paragjykimet dhe stereotipat e vazhdueshme, çështjet e pazgjidhura të së kaluarës, nacionalizmin dhe mungesën e besimit, komunitetet lokale të përfshira në hulumtim nuk duket të jenë në gjendje të arrijnë, as për së afërmi, një marrëveshje mbi ndonjë nga ngjarjet dhe proceset historike. Lufta më 2001, gjatë së cilës u përplasën dy komunitetet më të mëdha etnike, është ende e gjallë në kujtimet e njerëzve dhe perceptohet në mënyra tërësisht të ndryshme.

Edhe ato pak ngjarje historike që mund të shërbenin si ndërlidhës në mes të komuniteteve të ndryshme etnike, siç është Kryengritja e Ilindenit që atëkohë kishte një komponentë të fuqishme sociale dhe u bënte thirrje për kryengritje të gjitha komuniteteve përfshirë turqit lokal, apo Lufta e Dytë Botërore, nuk patën sukses për t'i sjellë komunitetet etnike më afër në kontekstin e ballafaqimit me të kaluarën dhe kujtesës në nivel lokal.

Një vëzhgim tjetër interesant, në mos të themi intrigues, është se asnjë pjesëmarrës në hulumtim nuk e ka përmendur Holokaustin dhe depërtimin e hebrenjve nga Maqedonia gjatë Luftës së Dytë Botërore. Ky është një aspekt shtesë që duhet të hulumtohet gjatë punës në të ardhmen për të ilustruar një nga dhomat e shumta të kujtesës, e cila vazhdon të jetë e rrethuar nga mure të heshtjes dhe të mohimit.

# KUJTIMET E VIKTIMAVE TË LUFTËS DHE TIRANISË NJË REFLEKTIM I PËRGJITHSHËM NË KONTEKSTIN GJERMAN

**G**jatë dekadave të fundit është bërë praktikë e njohur që pas përfundimit të luftërave, diktaturave dhe krimeve kundër njerëzimit të kërkohet ballafaqimi me krimet e së kaluarës.

Pyetja qenësore që shtrohet është se: a është e dobishme të ballafaqohesh aq intensivisht me humbjet e jetëve të njerëzve pas përfundimit të luftës dhe krimeve të dhunshme?!

Në historinë njerëzore ishte e zakonshme të tërhiqet një vijë pas së kaluarës dhe që njerëzit të mbaheshin përgjegjës para drejtësisë duke ofruar amnisti të përgjithshme. Mbi këtë bazë, mundësohej një fillim i ri në marrëdhëniet ndër-shtetërore dhe brenda shoqërisë. Sidoqoftë, kjo mënyrë e ballafaqimit me të kaluarën nënkuptonte amnistinë. Viktimat harroheshin; ato as nuk merrnin kompensim financiarë e as ndonjë lloj tjetër të asistencës sociale, derisa ata që kishin marrë pjesë në konflikte ushtarake ose krime publike mund të vazhdonin ta jetonin një jetë të mirë.

Mënyra për t'u marrë me historinë e krimeve, megjithatë, ndryshoi gjatë pjesës së fundit të shekullit XX. Rëndësi kryesore kishin krimet e kryera nga gjermanët gjatë epokës së Nazizmit, të cilat për shkak të dimensionit unik dhe pas një periudhe të "amnistisë" rezultuan në kërkesat për kulturë të duhur të kujtimit përtej instrumentalizimit politik.

Pas këtij dorëzimi, Gjermania u detyrua nga aleatët ta dëbojë ideologjinë naziste dhe t'u paguajë viktimave dëmshpërblime, pjesërisht individuale, por kryesisht shteteve si reparacione të luftës. Megjithatë, mbizotëroi një politikë e shtypjes së të kaluarës në të dy shtetet gjermane. Grupet e viktimave vazhdoreshin të diskriminoheshin dhe të përjashtohen nga shoqëria. Anëtarët e shumicës në shoqëri nuk kishin nevojë ta adresonin përfshirjen e tyre në krimet e kryera e as kryesit e drejt për drejt të krimeve nuk u persekutuan në nivel më të lartë.

Procesi gradual i ballafaqimit me të kaluarën nuk nisi deri në vitet 1970-ta. Grupet e marginalizuara u njohën zyrtarisht dhe morën kompensim financiar

dhe fonde shtetërore për interesin e tyre socialë dhe kulturorë. Historia e persekutimeve naziste u shërbeu atyre në krijimin e një formë të veçantë të përkujtimit të ndërlidhur me një proces të identifikimit grupor.

Sado e rëndësishme që ishte kjo si arritje shoqërore, çështja e dhënies së përgjegjësisë për këto krime u ngrit disa vite më vonë dhe krijoi një formë të vetë-reflektimit dhe vetë-sigurimit shoqëror që nuk duhet të nënvlerësohet. Është shumë e vështirë për një shoqëri t'i bëjë ballë pyetjes mbi mundësinë e përfshirjes së anëtarëve të saj në krime.

Në vijim mund të shihet se si Gjermania trajtoi krimet e kryera gjatë së kaluarës së saj naziste:

- Një mënyrë e sinqertë e trajtimit të krimeve shtetërore mund të kontribuojë që të sigurohet që të ndjekurit, të mbijetuarit dhe të afërmit e tyre të marrin kompensimin. Përveç mbështetjes financiare, njohja shoqërore mund të jetë një kontribut i rëndësishëm për një fillim të ri. Njohja e viktimave të huaja paraqet një hap të rëndësishëm në politikën e mirëkuptimit dhe njohjes reciproke edhe në marrëdhëniet ndërkombëtare.

- Çështja e kryesve të krimeve, në institucionet publike sikurse në nivel individual, mund t'u ndihmojë gjeneratave të ardhshme t'i vlerësojnë veprimet e qeverisë me një sy kritik dhe ta shpërbëjnë diskriminimin në shumë nivele-ndaj viktimave të së kaluarës dhe atyre të tashëm. Kjo paraqet një formë të rëndësishme të parandalimit veçanërisht sepse kryesit e krimeve duhet t'i frikësohen dhënies së përgjegjësisë.

- Vetëm nëse e kaluara trajtohet në mënyrë të sinqertë dhe gjithëpërfshirëse, është e mundur të parandalohet rishfaqja e saj dhe krijohen struktura të duhura në procesin shtetëror, të ketë pranimin shoqëror dhe të ndodhë përplasja me kundërshtarët e dikurshëm për të shmangur konflikte të ngjashme ushtarake apo krime publike.

- Nëse e kaluara, përfshirë pjesën e pakëndshme për secilën palë, shtypet, ekziston një rrezik konstant që ajo të rishfaqet dhe që të vazhdojnë konfliktet.



# BALLKAN100 : : BALLAFAQIMI ME TË KALUARËN : : : : :

**N**ë Strugë, *forumZFD* në Maqedoni, lansoi projektin Ballkan 100 prej datës 31 korrik e deri më 3 gusht të vitit 2014. Ky projekt synon të nis procesin e ballafaqimit me të kaluarat paralele, dhe shpeshherë konfrontuese, në Ballkan përmes ngritjes së vetëdijes mbi aspektet e ndryshme të identiteteve kolektive të komuniteteve në Ballkan. Njerëzit e rinj me interesa dhe përkatësi të ndryshme nga Bosnja e Hercegovina, Maqedonia, Kosova e Serbia marrin pjesë në këtë projekt. I tërë projekti do të zgjas tri vite dhe ka për qëllim të ofrojë një varg aktivitetesh sociale e edukative.

Gjatë punëtorisë në Maqedoni, pjesëmarrësit patën mundësinë të shtrojnë pyetje për të kaluarën individuale dhe atë kolektive, të përpiqen t'i vlerësojnë në mënyrë kritike qëndrimet personale mbi këto pyetje dhe të shkëmbejnë e krahasojnë tregimet e tyre. Për më shumë, punëtorja ofroi një studim antropologjik në fshatin Radoviste, ku pjesëmarrësit patën mundësinë ta shohin perspektiven dhe procesin e krijimit të kujtesës kolektive të banorëve të fshatit mbi mizoritë që kanë ndodhur në atë fshat në Luftën e Dytë Botërore.

Pavarësisht faktit që procesi i pranimit ka përfunduar, bashkësitë lokale dhe aktivitetet e tjera në kuadër të këtij projekti do të përfshijnë pjesëmarrës të rinj herë pas herë. Ballafaqimi me të kaluarën në Ballkan nuk duhet dhe nuk do të jetë privilegj i grupit të ngushtë të pjesëmarrësve në projektin Ballkan 100, por do të jetë në dispozicion për të gjithë ata që janë të gatshëm të vënë qëndrimet e tyre në pikëpyetje për të parë se a ka diçka që mund të mësojnë nga “të tjerët”.

*Artikulli u publikua fillimisht në portalin arkeologjik në internet: [arheon.org](http://arheon.org)*



**E**kaluara formon të tashmen përmes pranisë së saj në hapësirat publike dhe në kulturat zyrtare të përkujtimit përfshirë komemoracionet, iniciativat nëpër muze, librat shkollor, legjislacionin, komisionet dhe diskutimin politik. Vendet në hapësirat e ish-Jugosllavisë mund ta kenë një të kaluar të njëjtë, por në diskutet historike dominuese mbi 'të shkurtrin shekullin e njëzet' dallojnë në secilin shtet. Kjo u bë sidomos e dukshme pas shpërbërjes së Jugosllavisë dhe krijimit të shtet-kombeve të cilat, duke kaluar përmes tranzicionit, kanë kërkuar të ndahen nga narracionet e sunduesit të dikurshëm për të krijuar historitë kombëtare dhe kulturat e përkujtimit me theks të veçantë të ngjarjet e ndryshme historike dhe aspektet e tyre. Luftërat që pasuan shpërbërjen e Jugosllavisë ndihmuan këto procese. Narracionet e kontestuara në rajon përfshijnë nocione të ndryshme të së kaluarës së lavdishme, vuajtjes kolektive, viktimizimit dhe shpesh herë edhe mohimit të krimeve të bëra [nga vet shtetet] në të kaluarën. Për këtë arsye është i nevojshëm projekti Ballkan 100 me orientimin e tij rajonal. Duke sjellë bashkë jo vetëm studiues të rinj nga disiplina të ndryshme, por edhe njerëz të fushave të ndryshme, ai është një pjesë e rëndësishme e një procesi shumë të nevojshëm të ballafaqimit me të kaluarën dhe analizimit e vënies në pikëpyetje të narracioneve dominuese të historisë në rajon.

Ky projekt është ngushtë i lidhur me hulumtimin tim për doktoraturë, i cili fokusohet në ndryshimet e kulturës së përkujtimit të Luftës së Dytë Botërore në Serbi, ç'është një nga arsyet pse jam pjesëmarrës e projektit. Një aset tjetër i rëndësishëm i projektit për mua është fokusi i gjerë i tij, që përfshin jo vetëm ngjarjet historike dhe mundësinë për t'u angazhuar jo vetëm në kujtesën individuale por edhe atë kolektive në Ballkan. Kjo, bashkë me rrjetin, komunikimet joformale dhe diskutimet me pjesëmarrës të tjerë mbi aspekte të ndryshme të këtyre temave gjatë punëtorisë, e bëjnë këtë projekt një mundësi të shkëlqyeshme për të mësuar dhe shkëmbyer përvojat.

Jelena Dureinoviq  
*Kandidate PhD, Qendra Ndërkombëtare Post-diplomike  
për Studimin e Kulturës, Gießen*

**Q**ë nga vitet e 90-ta, programet nacionale të historisë, medias dhe kulturës popullore në Ballkan janë përqendruar kryesisht në krijimin e identiteteve kolektive të përshtatura me rrethanat e reja politike të kohës. Për shumë njerëz të rinj këtu, është e vështirë të braktiset ky diskurs meqë duket e natyrshe dhe normale, edhe pse nuk është. Ballkan 100 është një projekt i rëndësishëm përmes të cilit të paktën një nga të rinjtë do të mësohet të përdor qasjen shkencore postmoderne ndaj identiteteve dhe historive lokale në mënyrë që të sjellë më shumë mirëkuptim dhe paqe për të mirën personale dhe kombëtare. Për më shumë, shpresoj se përvoja e pjesëmarrësve do të ndahet me bashkësitë e tyre lokale në mënyrë që të arrihet ndryshimi sikurse në perceptimin e historisë ashtu dhe në jetën në përgjithësi.

Marko Barishiq

**N**jë nga intereset e mia të mëdha personale e profesionale është mirëqenia e njerëzve në zonat e post-konfliktit dhe veçanërisht në rajonin e Ballkanit Perëndimor. Ky projekt po me ofron një mundësi të mirë për të takuar, diskutuar dhe më e rëndësishmja për të bashkëpunuar me njerëz të shteteve të ndryshme në rajon. Besoj se ballafaqimi me të kaluarën është detyrë të cilën secila gjeneratë e re ne glob duhet ta kryejë, ndërsa për ne në rajon ballafaqimi me të kaluarën nganjëherë mund të jetë vendimtar në krijimin e një të ardhme më të mirë. Ballkan 100 më ofron hapësirën në të cilën mund të shtrojë pyetje dhe të marrë përgjigje, të hap [diskutime] mbi tema të reja dhe të zhvillojë projekte për të cilat kam pasion. Për më shumë, mezi pres të zhvillojë raporte të ngushta me pjesëmarrësit nga rajoni dhe të bashkëpunojë me ta në këto çështje.

Rodoljub Jovanović

**F**alja nuk fshin një të kaluar të hidhur. Një kujtim i shëruar nuk është një kujtim që mund të fshihet. Në të kundërtën, ta falësh atë që nuk mund ta harrosh krijon një formë të re të kujtimit. "Ne ndryshojmë kujtesën tonë për të kaluarën me shpresë për të ardhmen", thotë Lewis Smedes.

Ballafaqimi me të kaluarën, gjatë të cilit janë shkelur rëndë të drejtat e njeriut, është një nga sfidat më të mëdha me të cilat ballafaqohet shoqëria jonë. Ky projekt është shumë i qëlluar dhe domethënës sepse synon t'i inkurajojë shoqëritë të marrin përgjegjësi në promovimin e paqes.

Ky proces është shumë i vështirë dhe i dhimbshëm, veçanërisht për viktimat që kanë mbijetuar luftën, por jam mjaft e sigurt se kjo nuk është asgjë e paarritshme. Besoj se iniciativa të ngjashme duhet të ndërmerren edhe nga institucionet shtetërore dhe akterë të tjerë të rëndësishëm.

Përdorimi i nacionalizimit dhe religjionit si mjete për të nxitur urrejtje dhe dhunë nuk është aspak njerëzor. Gjeneratave të reja duhet t'u mësohet se duhet punuar për një të mirë të përbashkët pa rënë në grackën e së keqes. Projekte të tilla ndër-rajonale, veçanërisht ato që kanë për cak rininë, do të ndihmojnë në rivendosjen e marrëdhënieve sociale duke u bazuar në besimin e ndërsjellë, ndjeshmërinë, tolerancën dhe paqen. Kështu, historia e Ballkanit duhet të rishikohet, veçanërisht ajo e shkruar në librat shkollor që i shërbejnë gjeneratës së re. Unë besoj se gjëja më e rëndësishme në këtë proces është synimi i vendosur dhe insistimi për t'i mbetur besnik këtij synimi deri në fund pa marrë parasysh sfidat që mund të paraqiten në të ardhmen.

Interesimi për të marrë pjesë në këtë trajnim bazohet në dëshirën për të zgjeruar dhe thelluar njohuritë e mia në këtë fushë. Pasi diplomova në psikologji, mendoj se kjo do të më ndihmojë të kuptoj më mirë ndikimin e faktorëve të ndryshëm në të ashtuquajturën vetëdije kolektive.

Mendoj gjithashtu se do të mësoj mbi strategjitë të cilat njerëzit mund t'i përdorin për t'u ballafaquar në mënyrë efektive me të kaluarën.

Shejlla Avdiq



# “LABORATORI I KUJTESËS”: TA SHIKOSH BALLKANIN PERËNDIMOR SI PJESË INTEGRALE TË EVROPËS

.....

**P**ika nismëtare e platformës trans-evropiane “Memory Lab” (Laborator i Kujtesës) ishte e thjeshtë: Shumë njerëz që merren me të kaluarën në Evropën Perëndimore/Qendrore nuk dinë shumë se çfarë ndodhë në këtë fushë në Ballkanin Perëndimor dhe anasjelltas.

Kjo reflekton boshllëkun e përgjithshëm që vazhdon të ekzistojë në mes të Evropës Juglindore dhe pjesës së mbetur të Evropës. “Memory Lab” dëshiron të jetë një mundësi për të sjellë bashkë iniciativat e të dyja pjesëve të Evropës që merren me historinë e luftërave dhe dhunës masive në shekullin e XX, në mënyrë që ato të shkëmbejnë përvojat e njohuritë dhe të zhvillojnë aktivitete të përbashkëta.







Në përgjithësi, platforma mëton të kontribuojë në forcimin e qasjeve konstruktive të trajtimit të së kaluarës së vështirë dhe në zhvillimin e një hapësirë të kujtesës së përbashkët në Evropë, ku përvojat dhe praktikatat e Ballkanit perëndimor vlerësohen si më të rëndësishme dhe më të vlefshme se sa përvojat dhe praktikatat e shteteve të tjera evropiane.

Që nga vitit 2010, “Memory Lab” (I emëruar si “Trajtimi i së kaluarës së vështirë në Evropën Perëndimore dhe në Ballkanin Perëndimor” deri më 2013) për çdo vit organizon punëtori dhe udhëtime studimi në pjesë të ndryshme të Evropës. Pas Bosnjë e Hercegovinës më 2010 dhe Kroacisë më 2011, Francës më 2012, Gjermanisë më 2013, punëtorja dhe udhëtimi i studimit më 2014 u bë në Kosovë dhe në Maqedoni. Dyzet njerëz që punojnë në memorial, muze dhe organizata joqeveritare në Belgjikë, Bosnjë e Hercegovinë, Kroaci, Francë, Gjermani, Kosovë, Maqedoni, Holandë dhe Serbi morën pjesë në këtë program që ishte organizuar nga Iniciativa e të Rinjve për të Drejtat e Njeriut në Bosnjë, “forumZFD” në Kosovë, Zyra Franko-Gjermane për Rini “FGYO”, “Alter Habitus” dhe “Loja-Qendra për Bashkëpunim në Ballkan”.

Grupi kanë pasur rasti të vizitojnë memorialë të ndryshëm në Kosovë e Maqedoni, dhe të ndajnë ndau përvojat me njerëz që merren me çështjen e memorialëve në të dyja vendet si Nita Luci, Saranda Bogujevci dhe Goran Janev.

Aty ka pasur edhe sesione ku janë diskutuar temat.

Sikurse në vitet e mëparshme, programi ka ofruar gjithashtu një mundësi për të zhvilluar projekte bashkëpunimi ndërmjet organizatave pjesëmarrëse. Një rezultat direkt i “Memory Lab 2014” është fakti që Fondi për të Drejtën Humanitare në Kosovë, “YIHR” në Serbi, “Max-Mannheimer-Studienzentrum Dachau”, Departamenti për Rini i Limoges dhe “FGYO” planifikojnë të organizojnë për vitin 2015/2016 një cikël seminaresh për studentët nga Kosova, Serbia, Franca dhe Gjermania mbi temën “Krimet e luftës dhe gjykimet në Evropë”.

Pas Maqedonisë dhe Kosovës më 2014, “Memory Lab” i ardhshëm është planifikuar të mbahet në vitin 2015 në Belgjikë në mënyrë që të mësohen dhe shkëmbehen qasjet ekzistuese mbi trajtimin e trashëgimisë së Luftës së Parë dhe të Dytë Botërore, por edhe të historisë së kolonizimit dhe të shihet Muzeu i Historisë Evropiane që pritet të hapet në Bruksel më 2015.

*Për më shumë informata: [www.memorylab-europe.eu](http://www.memorylab-europe.eu)*



Nicolas Moll  
Koordinator gjeneral i “Memory Lab”



# PËR ATA QE S'JANË

**L**uftërat dhe represioni shtetëror kanë lënë shoqëritë të shpartalluara dhe shumë njerëz të traumatizuar, të zhvendosur apo të zhdukur.

Kosova është një shoqëri e tillë, e prekur thellë nga shkelje të rënda të të drejtave të njeriut. Çështjet me të cilat ballafaqohet popullata e Kosovës, si dhe institucionet e saj nisin nga mosbesimi në mesin e grupeve etnike, mohimit të të këqijave të kaluara deri tek mangësitë në aftësinë institucionale për pranimin social të ndryshimeve të mëdha.

Kalimi nga konflikti i armatosur dhe represioni në një gjendje të paqes dhe demokracisë funksionale, kërkon nga shoqëria që të marrë një qëndrim mbi shkeljet masive të të drejtave të njeriut që kanë ndodhur në të kaluarën e afërt. Me shpalljen e pavarësisë më 17 shkurt 2008, Kosova ka filluar të krijojë themelet për një fillim të ri. Në këtë kontekst, është thelbësore që të përqendrohet në shërimin e plagëve nga e kaluara traumatike dhe zgjidhjen e ankesave të gjithpranishme të popullsisë. Në Kosovë janë ende mbi 1500 persona për fatin e të cilëve nuk dihet gjë. Institucionet e Kosovës, që nga themelimi janë kritikuar në vazhdimësi për mosangazhim në zbardhjen e fatit të të zhdukurve nga lufta e fundit në Kosovë. Kritikat më të mëdha për këtë çështje u drejtuan sidomos vitin e kaluar, kur Kosova dhe Serbia hynë në dialogun për normalizim të raporteve.

Përtej obligimit shtetëror për të zbardhur këtë çështje, janë grupe të tjera që janë munduar të avokojnë dhe të gjejnë përgjigje për fatin e tashmë mbi 1500 të zhdukurve nga paslufta. Në përgjithësi mungon niveli i vetëdijesimit në mesin e qytetarëve për nevojën dhe format e realizimit të procesit të ballafaqimit me të kaluarën. Ekziston nevoja për sensibilizim të shoqërisë lidhur me domosdoshmërinë e ballafaqimit me të kaluarën si proces i rehabilitimit dhe normalizimit, por njëkohësisht edhe si proces i domosdoshëm për zbardhjen e të vërtetës për familjarët e viktimave dhe personave të afektuar nga lufta.

Duke dashur që të ndihmojnë në këtë proces janë edhe gazetari Dardan Hoti dhe fotoreporteri Fitim Selimi. Ata me vetiniciativë përmes shkrimeve dhe fotografisë po i sjellin rrëfimet.

Projekti i tyre, synon që t'i dokumentojë shkeljet e të drejtave të njeriut dhe të ndikojë në zhvillimin e shprehjes së duhur të përkujtimit dhe respektit për të zhdukurit në Kosovë. Po ashtu, përmes këtij projekti, Dardani dhe Fitimi, po synojnë të kontribuojnë për një diskutim më të gjerë me ballafaqimin me të kaluarën në tranzicionin e drejtësisë. Ata, po synojnë të sjellin rrëfime të familjarëve që nuk janë dëgjuar asnjëherë dhe atë nga tri komunitete që jetojnë në Kosovë e që janë atakuar drejtpërdrejt me këtë fakt (Romët, serbët dhe shqiptarët).





## Dokumentari

**D**o të krijojnë një film dokumentar për personat e zhdukur duke bërë intervista personale një-nga-një me anëtarë të familjeve/të personave të zhdukur, historitë e të cilëve kurrë nuk ishin dëgjuar më parë dhe që vijnë nga të gjitha përkatësitë etnike në Kosovë. Për herë të parë do të përgatisin një film dokumentar që paraqet historitë e njerëzve nga të gjitha përkatësive etnike në Kosovë në një film të vetëm. Ky dokumentar do të jetë specifik dhe i veçantë për faktin se do të fokusohet në tri afate kohore:

- E kaluara e të intervistuarit / e anëtarit të familjes / mikut të personit të zhdukur dhe një objekti të veçantë që ka mbetur nga kujtimet e përbashkëta.
- E tashmja e të intervistuarit / e të anëtarit të familjes / mikut të personit të zhdukur - sfidat dhe betejat.
- E ardhmja e të intervistuarit / e të anëtarit të familjes / mikut. Ne do të përgatisim një skenar koncept që do të përdoret si material kryesor gjatë xhirimit të këtij filmi.

## Si do ta bëjnë?!

Dardani dhe Fitimi, tashmë kanë idenë e tyre se si të kontribuojnë në këtë çështje. Ata, mendojnë të bëjnë publikimin e një shtojce në një gazetë, të punojnë një dokumentar dhe të shfaqin një ekspozitë.

## Shtojca

Shtojca do të përbëhet nga 12 faqe, ku secila prej tyre është një triptik që ka në fokus një të mbijetuar, nëpërmjet rrëfimit të të cilit/cilës, portretizohet personi i zhdukur. Do të jetë një fotografi, e ndarë në tre pjesë, përcjellë nga tre narrative mbi kujtimet, mungesën dhe jetën pas zhdukjes të secilit person individualisht.

## Ekspozita

**3** dimensione" është menduar të jetë edhe titulli i ekspozitës që do ta realizojnë si pjesë e këtij projekti. Tre dimensionet, do të tregojnë personazhin nga koka deri tek këmbët. Koka e personazhit do të japë një shpjegim. Duart në mes duke mbajtur një objekt apo diçka që i ka mbetur nga personi që është i zhdukur. Ndërsa, këmbët do të tregojnë ecjen e familjarit drejt zgjidhjes së çështjes së të zhdukurit dhe fatit të

tyre. Ata, përmes këtyre tri aktiviteteve synojnë: Ngritje të vetëdijes së qytetarëve; ngritjen e informimit për të rinjtë, kryesisht tek personat që nuk janë prekur direkt nga lufta e fundit në Kosovë dhe zhdukja e ndonjë familjari nga ajo luftë; ngritjen e kapaciteteve dhe rritjen e diskutimeve tek të rinj dhe krijimit të mendimit të tyre për të kaluarën dhe luftën. Shikuesit do të mësojnë "anën tjetër të tregimit" të familjarëve.



# KOSOVA DHE MAQEDONIA: NË KËRKIM TË IDENTITETIT

**N**jë udhëtim studimi në Kosovë e Maqedoni riafirmoj dhe përmirësoi botëkuptimin tim mbi memorializimin e ngjarjeve të së kaluarës. Ne kemi vizituar shtete që kanë kaluar nëpër konflikte të armatosura në tokën e Jugosllavisë së dikurshme.

Në Kosovë, konflikti ka lënë prapa vetes ndarje të thella ndërmjet dy komuniteteve, të cilat tani bashkë-ekzistojnë në botëra të ndara që ndërthuren vetëm herë pas herë. Ekziston një përshtypje se me moralizimi po bëhet sipas këtij modeli dhe për këtë arsye monumentet janë ekskluzivisht mono-etnike. Shteti i Kosovës ka ngritur vetëm disa monumente shtetërore dhe është më shumë i fokusuar në krijimin e identiteteve bazuar në tipare të tjera, kryesisht të përqendruara në pavarësinë e vendit nga Serbia. Kosova dhe qytetarët e saj duan të krijojnë një identitet që s'ka të bëjë aspak me Jugosllavinë, Ballkanin e aq më pak me Serbinë. Sipas pikëpamjes sime, ekziston deri diku një krizë identiteti. Flamujt e Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe Bashkimit Evropian mund të shihen duke vluar mbi institucionet shtetërore si homazhe për përkrahësit dhe miqtë e Kosovës.

Memoriali i Gazimestanit dhe monumenti i "Bashkim-Vëllazërimit" (Bratstvoje-dinstvo) janë në mbrojtjen shtetërore në kuadër të projekteve për demoralizim dhe, rrjedhimisht, lënë në harresë e kanë ndryshuar për t'i reflektuar nevojat e shtetit të ri të Kosovës. Përshembull, figurat e njerëzve në monumentin "Bashkim - Vëllazërimi"

janë ngjyrosur dhe duken si flamujt e fuqive kryesore që kanë mbështetur krijimin e shtetit të ri të Kosovës. Kështu, është kaluar nga njëri program shtetëror mbi kujtesën në një tjetër. Elitat politike kanë vendosur të kujtojnë vetëm një pjesë të së kaluarës, atë për të cilën besojnë se është e "vlefshme" për ta kujtuar. Duke e bërë këtë, ata kanë përkrahur epokën socialiste me gjithë mjerimin e harresës që ishte në kundërshtim me vitet e '90, sepse ajo dekada e përgjakshme rezultoi me pavarësinë e Kosovës.

Kompleksi "Adem Jashari" paraqet një projekt shtetëror të Kosovës për memorializimin e luftës së 1998-1999. Memoriali është caktuar si memorial dhe mirëmbajtur nga shteti, por është mbështetur edhe nga anëtarët e familjes Jashari që kanë mbijetuar dhe ende jetojnë atje. Kjo i jep memorialit një kuptim të ri-kundërshtimitin e vdekjes, pavdekshmërinë. Në këtë kuptim, politikën e demoralizimit në Kosovë vërtet të dallojnë nga ato në Kroaci. Në Kroaci, shteti ka vendosur shumë monumente për ta kujtuar Luftën për Atdhe (Domovinski rat – emër që përdoret për luftën e vitit 1990, që vetvetiu është simbolikisht i fuqishëm).

Sipas mendimit tim, në Kosovë mbizotërojnë monumentet e ngritura si rezultat i iniciativave private. Qytetarët

kanë pasur nevojë të kujtojnë dhe shënojnë kujtimet e tyre përtej fushëveprimit të shtetit. Si rezultat, ekziston një qasje ekstremist kaotike dhe pabarabartë ndaj memorializimit. Në anën tjetër, kjo qasje që lë përshtypjen e ekzistimit të autenticitetit dhe privatësisë gjatë vizitës së këtyre memorialeve. Monumente të tilla ekzistojnë edhe në Kroaci, por ato zakonisht vijnë nga bashkësitë lokale dhe organizatat e viktimave të udhëzuara nga politikanët.

E ngjashme është situata në Maqedoni ku memorializimi është bërë i ndarë ndërmjet ngjarjeve komemorative publike e private të së kaluarës. Projekti "Shkupi 2014" është projekt shtetëror i nivelit meta-ideologjik, i cili "me forcë" tenton të ndërtojë një identitet të bazuar në një të kaluar të konstruktuar dhe të manipuluar. Monumentet u dërgojnë qytetarëve të etnisë shqiptare një mesazh të fuqishëm mbi mono-etnicitetin dhe mbylljen në vetvete. Kjo mund të shihet nga lokacioni i monumenteve. Ekziston një ngjashmëri me projektet shtetërore në Kroaci. I vetmi dallim është se projekti maqedonas është stërmadhur dhe arrin më në thellësi të së kaluarës.

Monumentet e nivelit lokal dhe privat, ndërkaq, janë ndryshe. Memorialët e dedikuara për qytetarët e vrarë në fshatin Neproshtetno përfaqësojnë një mënyrë të vogël, lokale dhe

private të përkujtimit. Memoriali nuk dërgon ndonjë mesazh urrejtjeje e as nuk flet për kryesit e vrasjes. Ai dallon nga memorialët në Kroaci, të cilat drejtojnë gishtin kah vrasësit. Madje edhe krijuesit dhe sponsorizuesit e monumenteve thonë se ky monument është i hapur për çdokënd dhe se tensionet ndër-etnike janë të mira. Më pas, kemi zbuluar se në të njëjtin fshat janë vrarë edhe disa shqiptarë, por se emrat e tyre nuk janë shënuar në monument. Andaj, krijohet prapë përshtypja se monumenti është mono-etnik dhe se tregon vetëm gjysmën e historisë.

Memoriali i dytë, i krijuar pas iniciativës private dhe lokale, ishte "Nëna shqiptare". Memoriali është rezervuar vetëm për shqiptarët në emër të tyre. Fillimisht, ai kishte për qëllim të shërbente si memorial për viktimat shqiptare në Luftërat Ballkanike më 1912-1913, por u bë pastaj monument për të gjithë shqiptarët që janë vrarë dhe kanë vuajtur si pasojë e luftërave të shumta në rajon. Memoriali është mjaft kaotik me një ide të paqartë. Më i paqartë është komenti i një prej përcjellësve tanë i cili tha se, pavarësisht emrit, flamurit shqiptar dhe simboleve të tjera, ky monument do t'u dedikohet të gjithë qytetarëve përfshirë maqedonasit. Niveli i fshehtë së karakterit kombëtar të memorialit dhe mohimi i mosmarrëveshjeve ndër-etnike e konflikteve dallon tërësisht nga Kroacia. Në Kroaci, monumentet janë pothuajse tërësisht mono-etnike dhe askush nuk përpiqet ta fsheh këtë, sepse identiteti "kundër" ose "në kundërshtim" me identitetet e tjera është themeli i identitetit kroat.

# ZËRAT E PËRBASHKËT

Në muajt në vazhdim ne bëmë

bashkë një grup shumëngjyrësh të muzicentëve, gazetarëve, hulumtuesve, ndërmarrësve, njerëzve fetarë dhe atyre nga shoqëria civile: gra dhe burra të rëndomtë nga Kosova të cilët shtigjet e ndryshme të jetë si sollën bashkë për t'u argëtuar me procesin e realizimit të ngjashmërive dhe dallimeve me të tjerët.

**D**ukagjin Gorani, kryetar i Forumit “Common Voice”, rikujton procesin e formimit të një platforme për parandalimin e konfliktit dhe evokimin për komunitete në Kosovë.

Ishte një ditë me diell në Shtator të vitit 2013 kur në receptionin e hotelit “Hayatt” në Beograd mu drejtua me një propozim Paul Partner, këshilltar për Paqe dhe Zhvillim në Departamentin për Marrëdhënie Politike të Kombeve të Bashkuara dhe të UNDP-së në Kosovë. Ai kishte përcjellë për së afërmi punimet e një Forumi të njohur për Sigurinë në Beograd ku unë, së bashku me disa kolegë të tjerë të shoqërisë civile të Kosovës, patëm rastin për të folur. Paul po shqyrtonte mundësinë për riprodhimin e një diskursi të arsyeshëm të atij paneli, por si një gjë më të madhe e më të spikatur. Ai pyeste vetën nëse ajo gjë mund të bëhej pjesë e përbashkët e gjuhës publike të Kosovës mbi njohuritë ndër-etnike. Ai imagjinonte një grup më të madh të njerëzve të ngjashëm, të njohur e të zakonshëm, që do të përbënin një forum të rëndomtë, i cili do të krijohet vetëm për shkak të përkushtimit personal të tyre për të bashkë-ekzistuar në paqe dhe për të bashkëpunuar.

Në fillim të prillit të vitit 2014 ne caktuam takimin tonë të parë. Budva e Malit të Zi mund të bëhet e juaja dhe me të vërtetë vetëm e juaja. Për dy ditë me radhë anëtarët e grupit modest ishin vazhdimisht të magjepsur me njëri-tjetrin. Diskutime pa mbarim, ide, dëshira, mënyra të të folurit, të të menduarit dhe të të vepruarit. Paul Mecklenburg, këshilltar special i Përfaqësuesit të Posaçëm të Kombeve të Bashkuara në Kosovë, Farid Zarif, vuri re një fakt të rëndësishëm në mënyrën e mprehtë të një Amerikani. “E keni një gjë kaq të mrekullishme duke ndodhur këtu. Vlerësojeni atë, mos e humbisni”. Aq e vërtetë.

Pas Budvës erdhi Graçanica, Ohri, Kopaoniku, Tirana me takime që u mbajtën në ndërkohë në Prizren, Prishtinë dhe Mitrovicë. Me kalimin e kohës, ky forum i jashtëzakonshëm i njerëzve të rëndomtë mori një emër të ri. “Common Voice”- platforma për parandalimin e konfliktit dhe evokimin për komunitete. Së fundi, forumi u vendos në zyrat e Qendrës Liberal Demokrate, një thinj –tanku në Lagjën aktash në Prishtinë.

Këtu, sekretariati i tij i kryesuar nga Bekim Beka dhe Zarko Krtiniq, përgatit takime dhe sesione me anëtarët e forumit. Është vendi ku ndalen njerëz si Besa Luzha, Petar Miletqi, Shkumbin Brestovci, Veljko Samardziq, Lejla Haxhiu-Pula, Kujtim Paçaku, Dardan Velija, Birol Urcan, Blerta Avdili, Ljubisa Bascareviq dhe shumë të tjerë. Ata janë të angazhuar në përgatitjen dhe zbatimin e një varg projektesh diverse: duke nisur nga rekomandimet për politika e deri tek filmat dokumentarë; nga deklaratat për publik e deri te ngjarjet kulturore.

Eja na vizito edhe ti!



## GISHTI

*“The Finger” (Gishti) është gishti tregues, që nuk di kah të tregojë dhe që nuk është në gjendje ta gjejë kryesin e vepërës. Kjo shfaqje paraqet hijen e një gishti gjigant që drejtohet kah ti duke të bërë të ndihesh fajtor. Ai është gishti që ofron edhe pajtimin edhe ndarjen. Ai është arsyetimi yt për të qarë mbi dhembjen e parëndësishme të shkaktuar nga puna e parëndësishme në shtëpi, i si një maskë për një dhembje më të rëndësishme që ke brenda vetes. Ai është një kujtues permanent i faktit që diçka e keqe është bërë dhe se gjithçka mund të shkatërrohet. Ai është një kërcënim. Ai është një gjë me të cilën e çjerr veten. Ai është një gjë me të cilën prek” -Doruntina Basha.*



**P**rej rreth 30 mijë njerëzve që janë zhdukur në Bosnjë e Hercegovinë, ende duhet të gjenden edhe 9 mijë. Drama e luftës, që mori fund para përfundimit të shekullit të fundit, është ende ekzistuese për familjet e tyre. Shpresa vdes me vdekjen e kërkuesit. Kërkimi në vete është ajo që artistët dhe qytetarët tanë kanë të përbashkët. Teatri është vend i kërkimit, vend i shpresës, vend i kërkimit të së vërtetës dhe vendit ku njeriu mund ta gjejë të vërtetën. Mund të thuhet se fakti është më shumë se sa një arsye e mjaftueshme se përse Teatri i Luftës në Sarajevë (SARTR) vendosi ta shfaq dramën “The Finger” (Gishti) të Doruntina Bashës.

The Finger është një tregim mbi pikëllimin dhe shpresën dhjetëvjeçare të një nënë dhe një bashkëshorteje të cilat shpresojnë në mrekullinë e rikthimit të të birit dhe bashkëshortit të tyre. Këto dy gra ndiejnë dhembje të pafund për personin që kanë humbur dhe përpiqen të ballafaqohen me të vërtetën. Këtë e bëjnë duke i shkaktuar dhembje e duke akuzuar njëra-tjetrën, duke luftuar se cila ka më shumë pushtet mbi tjetrën, duke mos mbështetur njëra-tjetrën, duke mos qenë në gjendje të jetojnë me njëra-tjetrën, por duke mos qenë në gjendje as të jetojnë pa njëra-tjetrën. Ato ndihen të gjalla vetëm gjatë kësaj lufte dhe këtyre lëndimeve të anasjellta. Kjo është bota e familjeve dhe e të afërmeve e 9 mijë personave ende të pagjetur.

Bota, të cilën nuk e njeh askush përveç tyre. Edhe pse drama “The Finger” është e vendosur në kontekstin e çështjes së personave të pagjetur, rrëfimi tregohet tërësisht nga perspektiva e grave që kanë mbetur të vetmuara-në kurth brenda vetes. Qëllimi i performimit të kësaj drame nuk u është dorëzuar vetëm artistëve dhe aktorëve, por edhe grave, nënave, motrave, bijave, bashkëshorteve... Ato janë në kërkim të së vërtetës, drejtësisë, dashurisë, bukurisë, paqes; ato janë në kërkim për të gjithë ne-NJERËZIT E ZHDUKUR!

Premiera e “The Finger” u shfaq më 7 Nëntor, 2014, në “SARTR”. Shfaqja u performua në kuadër të produksionit të Teatrit të Luftës në Sarajevë me mbështetjen e Departamentit për Marrëdhënie me Publikun të Ambasadës Amerikane në Sarajevë dhe në bashkëpunim me “forumZFD” në Bosnjë dhe “Foundation Publika”. Sponsoruesi kryesor i “SARTR” është Telekom i Bosnjës.

Tryeza e rumbullakët e diskutimit me temën “Ndërmjet Shpresës dhe Historisë” u mbajt më 10 Nëntor 2014 pas shfaqjes në “SARTR”. Panelistët në këtë tryezë të rumbullakët ishin: Doruntina Basha (dramaturge), Viktorija Ruzhiçiq-Tokiç (ICMP), Sabrina Begoviç (drejtoreshë), Selma Alispahiç (aktore) dhe Selma Korjeniq (TRIAL). Shfaqja “The Finger” do të jetë pjesë e repertuarit të SARTR për vitin 2015.





# GAZETARËT MAQEDONAS: BALLAFAQIMI ME TË KALUARËN ËSHTË I DOMOSDOSHËM PËR MEDIET

**G**azetarë të medievetë ndryshme besojnë se ballafaqimi me të kaluarën është sfidë e vërtetë për gazetarët dhe mediet në Maqedoni. Ata thonë se gazetarët e njohin këtë koncept por pranojnë se ka pak përpjekje për t'u përballur. Anita Dimitrijevska, gazetare e televizionit shtetëror, ka thënë se raporton për këtë çështje vetëm nëse ka ndonjë ngjarje në raport me temën. “Vetëm disa gazetarë marrin iniciativën që fokusojnë raportin e tyre në çështjen e lartpërmendur, media, posaçërisht ato të shkruara nuk marrin iniciativa për shkak të mungesës së kapaciteteve”, ka thënë Dimitrijevska.

Aderim Kerimi nga ALSAT-M ka thënë se “mediet në Maqedoni mësojnë nga mediet në vendet tjera, posaçërisht ato në Afrikë se si duhet ballafaquar me të kaluarën”.

Salie Sadiku, gazetare në TV Gurra në Kërçovë beson se ballafaqimi me të kaluarën duhet të bëhet edhe ga mediat lokale pasi që shumica e komunave maqedonase janë shumë etnike.

“Kemi shembull Kërçovën që është një qytet i vogël me dy etnitete: maqedonasit dhe shqiptarët. Gjatë zgjedhjeve të fundit lokale këtu pati tensione dhe gjuhët ë urrejtjes. Kjo ka ndodhur për shkak të paragjyqimeve ndaj njëri tjetrit dhe një beteje ndëretnike dhe jo për shkak të ndonjë përpjekje për të zgjedhur kandidatin më të mirë”, ka thënë ajo.

# GAVRILLO PRINCIPE - HERO KOMBËTAR APO TERRORIST?



## SERBIA

“Terroristi për një person tjetër është luftëtar liric”. Një qind vite pas atentatit të Sarajevës shtrohet sërish pyetja se cili emërtim duhet të zgjidhet për Gavrillo Principen. Në qershor të vitit 1914, Principi qëlloi për vdekje trashëgimtarin e fronit austriak, Franz Ferdinand, dhe shkaktoi me këtë një varg ngjarjesh që çuan në shpërthimin e Luftës së Parë Botërore. I nxitur nga dëshira për çlirimin e Bosnjës, ai kreu një vrasje politike pasojat e së cilës ishte e pamundur të parashikoheshin, as për të e as për politikanët në Serbi dhe Evropë. Vlerësimi ambivalent i veprimit të tij është ende i pasqyruar në marrëdhëniet e serbëve me historinë e re të tyre. Ata vazhdojnë të kundërshtojnë pikëpamjen se mbështetja e Serbisë ndaj Principes ka kontribuar në shpërthimin e luftës. Ekziston një shqetësim ndaj versionit të historisë sipas së cilës serbët janë përgjegjës për të gjitha të këqijat që kanë ndodhur në Ballkan pas vitit 1914. Principe cilësohet si hero kombëtar në Serbi. Në ndërkohë, është e vërtetë se më 1914 sikurse më 1991 ka pasur rryma nacionaliste në Serbi, por barazimi është i papranueshëm. Principe ka punuar për shtetin në të cilin ishte parashikuar të jetonin së bashku të gjithë sllavët e jugut. Për dallim nga kjo, regjimi i Millosheviqit predikoi nacionalizëm serb. Sot, Serbia luan një rol pozitiv në procesin e pajtimit në rajon.

# LAJME DHE PËRDITËSIME

## HARTËZIMI I KUJTESËS

Projekti “Memory Mapping Kosovo” ka për synim të sjell bashkë një grup të ekspertëve të shkencave sociale, studentëve dhe aktivistëve të shoqërisë civile për të eksploruar praktikat dhe vendet të memorializimit në Kosovë, për t’i krahasuar ato me narracionet e vendosura historike dhe material arkivor duke prodhuar një perspektivë të re të kuptimit të memorializimit në Kosovë që do t’i kontribuojë debatit mbi ballafaqimin me të kaluarën në Kosovë. Brenda periudhës janar-qershor 2015, projekti MMK do të fokusohet tek punët në tri nga pesë atelietë duke shtjelluar një varg temash në kuadër të të cilave hyjnë:

Monumentet e vendosura brenda regjimit osman në Ballkan (1878-1881)- “Lidhjes së Prizrenit”, (shkurt 2015); monumentet e ngritura brenda regjimit socialist në Jugosllavi, por që janë lënë pas dore prej se mori fund lufta në Kosovë më 1999, “Monumenti i minatorëve” (prill 2015); dhe perspektivat mbi viktimat (femra) të sulmit seksual gjatë luftës në Kosovë (qershor 2005).

Korab Krasniqi

## MEMORINMOTION: NJË VARG MJETESH PËR TA ANGAZHUAR RININË ME HISTORINË DHE KUJTESËN

Gjatë verës së vitit 2014, “forumZFD, Iniciativa e të Rinjve për të Drejtat e Njeriut në Bosnjë, dhe Shtëpia “Anne Frank” nisën projektin “Memorinmotion”. Projekti përfshin një varg mjetesh edukative që kanë për qëllim t’i angazhojnë të rinjtë në Bosnjë e Hercegovinës dhe të tjera vendeve në shtjellimin e historisë së tyre me synim që ata të mbështeten në reflektimin kritik të kulturës së tyre publike të kujtesës. Mjetet janë në dispozicion që nga dhjetori i vitit 2014 dhe do të shpërndahen në vitin 2015. Ky bashkëpunim ndërtohet mbi bazën e dy projekteve të partnerëve të njëjtë: projekti “Memory Walk” (YIHR BiH/AFH) dhe projekti “MONUMENTImotion” (forumZFD), të cilët ua mundësuan të rinjve që t’i paraqesin pikëpamjet e tyre mbi kujtesën historike përmes filmit. Për më shumë informacione ju lutem kontaktojeni: Michele Parente (parente@forumzfd.de) ose Laura Boerhout (l.boerhout@annefrank.nl).

Laura Boerhout  
(Anne Frank House)

## TEMA E RADHËS

Në numrin e radhës në “Balkan.Perspectives” do të lexoni për çështjen e heronjve. Autorët do të analizojnë se si njerëzit e definojnë heroin dhe se si individët bëhen heronj. Poashtu do të shqyrtohet për kujtimi i heronjve në Ballkan dhe ne do të shtrojmë pyetjen: A na nevojiten heronjtë?



# IMPRESUM

*Balkan.Perspectives* publikohet nga forumZFD.

Forumi Shërbimi Civil për Paqe (*forumZFD*, Forum Ziviler Friedensdienst), është organizatë gjermane e themeluar në vitin 1996. Si e tillë, *forumZFD* trajnon dhe angazhon ekspertë të paqes në rajonet e konfliktit ku ata bashkëpunojnë me aktorët vendorë për të promovuar zgjidhjen paqësore të konflikteve dhe bashkë-ekzistencën paqësore.

Në Ballkanin Perëndimor, fokusi qëndron në projektet e ballafaqimit me të kaluarën dhe të zhvillimit të dialogut në mes të grupeve opozitare. Kjo përfshin projektet e ndërmjetësimit, mbështetjen e shoqërisë civile ose zhvillimin e kapacitetit të mediave për një qasje më konstruktive në ballafaqimin me të kaluarën.

Programi financohet nga Ministria Federale Gjermane për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim.

## Kryeredaktore:

*Maike Dafeld*

## Autorët:

*Shejlla Avdiq, Marko Barishiq, Laura Boerhout, Xhabir Deralla, Jelena Dureinoviq, Dukagjin Gorani, Dardan Hoti, Mefail Ismaili, Rodoljub Jovanoviq, Nihad Kresevljakoviq, Dr. Thomas Lutz, Sven Milekiq, Nicolas Moll, Dino Mustafiq, Nikola Radiq, Johannes Rueger, Fitim Selimi, Maja Vaseva*

## Faqosja:

*Kokrra*

## Fotografia në ballinë:

*Layla Baraké*

## Shtypi:

*CPU Printing company d.o.o. (Bosnjë e Herzegovinë), VM3 (Kosovë), Fokus Print (Maqedoni), Kolor Press (Serbi)*

## Përkthimi:

*Luljeta Krasniqi Veseli (Shqip), Martin Lewerentz (Gjermanisht), Emica Niami-Nalbantic (Maqedonisht), Ivan Stanojeviq (Bosnjakisht, Serbo-Kroatisht)*

## Lekturimi:

*Jack Davies (Anglisht), Arben Ahmeti (Shqip), Zinaida Lakiq (Bosnjakisht, Serbo-Kroatisht), Silvana Krzovska (Maqedonisht)*

## Kontakti:

*Balkan.perspectives@forumzfd.de*

Forumi Shërbimi Civil për Paqe | Forum Ziviler Friedensdienst e.V. (*forumZFD*)

Zyra në Kosovë: Qamil Hoxha 8/3 10000 Prishtinë, Kosovë	Zyra në Serbi: Prote Mateje 17 11000 Beograd, Serbi
---	---

Zyra në Bosnjë e Herzegovinë: ul. Branilaca Sarajeva 19 B 71000 Sarajevë, Bosnjë e Herzegovinë	Zyra në Maqedoni: ul. Borka Taleski 11/4 1000 Shkup, Republika e Maqedonisë
--	---

## Mohim

*Balkan.Perspectives* synon të iniciojë debate mbi ballafaqimin me të kaluarën në Ballkan. Pikëpamjet e paraqitura në këtë revistë janë ato të kontribuesve respektivë dhe nuk reflektojnë domosdoshmërisht pikëpamjet e redaktorit apo të *forumZFD*. Derisa publikuesit kanë kontrolluar me kujdes linqet e internetit të promovuar në këtë revistë, ata nuk mund të mbahen përgjegjës për përmbajtjen e këtyre faqeve të internetit.

Jeni të mirëseardhur ta kopjoni dhe rishpërndani këtë material në të shtypur apo në formën elektronike vetëm nëse nuk ndryshoni tekstin, nëse citoni burimin dhe nëse nuk kërkon të holla në këmbim të kopjes.

